

LIGJ
Nr.10 475, datë 27.10.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9901, DATË 14.4.2008 “PËR TREGTARËT DHE
SHOQËRITË TREGTARE”¹**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Në nenin 107, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Shoqëria aksionare me ofertë private nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 3 500 000 lekë.”.

Neni 2

Në nenin 187, në fund të pikës 1 shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) kur kapitali i shoqërisë aksionare bie nën minimumin ligjor të kërkuar nga neni 107 i këtij ligji.”.

Neni 3

Shoqëritë aksionare ekzistuese, me ofertë private, që janë themeluar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të detyruara të përfundojnë procedurat për regjistrimin e rritjes së kapitalit, të paktën deri në shumën e përcaktuar sipas nenit 1 të këtij ligji, brenda 1 viti pas hyrjes në fuqi të tij.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7154, datë 10.11.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

1 Ky ligj është përafshuar plotësisht me Direktivën e Dytë të Këshillit 77/91/KEE, datë 13 dhjetor 1976 “Mbi koordinimin e masave mbrojtëse nga shtetet anëtare, të cilat nevojiten për ruajtjen e interesave të anëtarëve dhe të tjerëve, për kompanitë, sipas kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 58 të Traktatit, lidhur me krijimin e shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuar, mbajtjen dhe ndryshimin e kapitalit të tyre, me qëllim për t’i bërë këto masa mbrojtëse ekuivalente”. Numri CELEX: 31977L0091, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 26, datë 31.1.1997, faqe 1-13.